
24 Do të fillojmë me pyetjet e Prokurorisë. Ju lutem,
25 dëgjojini me vëmendje.

1 Vazhdoni, z. Michalczuk.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

3 Pyetje nga z. Michalczuk:

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

5 PY. Mirëdita, dëshmitar. Jemi takuar edhe më përpara, më
6 herët gjatë kësaj jave. Sidoqoftë, unë të prezantohem edhe një
7 herë. Quhem Cezary Michalczuk, dhe do t'ju bëj pyetjet nga ana
8 e Prokurorisë. A jeni gati?

9 PË. Po.

10 PY. Si e keni emrin dhe mbiemrin?

11 PË. Zoran, Zoran Stankovic.

12 PY. Datëlindja juaj cila është?

13 PË. 23 maj, i vitit 1973.

14 PY. Po vendlindja?

15 PË. Gjilan.

16 PY. Po etnia juaj?

17 PË. Serb.

18 PY. Dëshmitar, a ju ka intervistuar ndonjëherë më përpara

19 ZPS-ja?

20 PË. Po.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës
22 të vendosë në ekran dokumentin në anglisht dhe në serbisht.
23 Dokumenti ka numrin 092954-TR-ET pjesa 1, RED. Dhe siç ju
24 thashë, përbri edhe serbishtja me të njëjtët numra, vetëm se
25 përfundon me ST në fund.

1 PY. Dëshmitar, e shihni dokumentin përpara në ekran?

2 PË. Po.

3 PY. E keni dhënë ju këtë deklaratë?

4 PË. Po.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Lutem tani Sekretares së
6 Gjykatës të nxjerrë dokumentet e radhës, dhe në anglisht dhe
7 në serbisht. Anglishtja është në faqet SITF00162664 deri në
8 SITF00162674-ET RED2, dhe serbishtja me të njëjtën ERN por
9 përfundon me RED në fund.

10 PY. Dëshmitar, ishin deklaratat i shihni deklaratat përpara
11 në ekran?

12 PË. Po.

13 PY. I keni dhënë këto deklarata?

14 PË. Po.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të vendosim në ekran një
16 dokument tjetër. Anglishtja është me SITF00195352 deri në
17 SITF00195370 ET Revised RED2. Serbishtja ka të njëjtin numër,
18 por është me RED në fund. Shkojmë ju lutem më poshtë në faqen
19 në serbisht, që të shohim fundin e saj.

20 PY. Dëshmitar, shihni pak fundin e faqes. A është nënshkrimi
21 juaj?

22 PË. Po.

23 PY. E keni dhënë ju këtë deklaratë?

24 PË. Po.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I lutem tani Sekretarit të

1 Gjykatës të nxjerrë në ekran dokumentet e tjera. Anglishtja ka
2 numrin SITF00271891 deri në SITF00271891-ET. Serbishtja është
3 njësoj, thjeshtë që nuk ka shkronja në fund, ka vetëm numrat.
4 Ju lutem të shkojmë më poshtë në faqe.

5 PY. Dëshmitar, e njihni nënshkrimin tuaj në fund të kësaj
6 faqeje?

7 PË. Po.

8 PY. Ju e keni dhënë këtë deklaratë?

9 PË. Po.

10 PY. Në kuadër të përgatitjes për ditën e sotme, a patët
11 mundësi të rishikonit edhe një herë përmbajtjen e këtyre
12 deklaratave?

13 PË. Sot e keni fjalën, tani?

14 PY. A të kujtohet që u takuam bashkë në fillim të kësaj jave?

15 PË. Po.

16 PY. A i rishikove edhe një herë deklaratat atë ditë që u
17 takuam bashkë?

18 PË. Po.

19 PY. Gjatë asaj seance, seanca përgatitore që kishim bashkë, a
20 pate mundësinë të bëje disa sqarime apo korrigjime në këto
21 deklaratata?

22 PË. Jo.

23 PY. Po a mbani mend që u takuam bashkë ditën e hënë?

24 PË. Po.

25 PY. A të thamë ne a do t'u bësh ndonjë korrigjim a ndonjë

1 sqarim këtyre deklaratave?

2 PË. Po. Po, po. Po, ke të drejtë, korrigjova diçka.

3 PY. Këto ndryshime dhe këto sqarimet, a u hodhën në një
4 shënim të cilin më pas ta lexuam sërish?

5 PË. Po.

6 PY. A e konfirmoni se ato që iu lexuam që ishin në atë
7 shënim, pasqyrojnë tërësisht dhe në mënyrë të saktë ndryshimet
8 që bëtë?

9 PË. Po.

10 PY. Duke marrë parasysh edhe ndryshimet, këto deklaratat
11 pasqyrojnë saktësisht atë që kishit thënë dhe që do të thoshit
12 sërish nëse do t'iu pyesnin në sallën e gjyqit sot?

13 PË. Nuk e kuptova. Nuk e kuptova. Përsëriteni dhe --
14 ndonjëherë kam edhe shkëputje të zërit përmes dëgjuesve.

15 PY. Duke marrë parasysh edhe ndryshimet që ju lexuam te ai
16 shënimi, deklaratat jua a pasqyrojnë saktësisht atë që keni
17 thënë në të shkuarën dhe që do të thoshit sërish sot në sallën
18 e gjyqit.

19 PË. Po.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi
21 përmbusha kriteret e rregullës 154 dhe në përputhje me
22 vendimin e Trupit Gjyqësor me numër F02339, ZPS-ja kërkon që të
23 pranohen të gjitha deklaratat e mëparshme të këtij dëshmitari,
24 në të treja gjuhët, bashkë me provat materiale shoqëruese që
25 kanë numrin 095952 deri në 092953, të evidentuara në

1 paragrafin përkatës -- paragrafin 26 të atij vendimi.
2 Gjithashtu kërkojmë që të pranohet Shënimi Përgatitor nr. 1,
3 që mban numrin 121296 deri në 12133301 që është dërguar më 3
4 qershor.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
6 kundërshtime?

7 Asnjë nga ekipet e mbrojtjes nuk ka kundërshtime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 Materiali me numër 192 - ju kërkoj ndjesë. 092952 [Sipas
10 përkthimit] bashkë me përkthimin në gjuhën serbe, pranohet.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pjesa 1 merr numrin e
12 provës materiale -- pjesa 1 anglishtja, shqipja dhe
13 serbishtja, marrin numrin e provës materiale P01297.1 me
14 klasifikim konfidencial.

15 Janë edhe dy pjesë të tjera të së njëjtës deklaratë.
16 Pjesa 2 të njëjtës deklaratë, anglisht, shqip merr numrin e
17 provës materiale P01297.2 ndërsa pjesa 3 merr numrin P01297.3,
18 me klasifikimin e konfidencial për të tre pjesët.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshironi që
20 t'i mbajmë klasifikimin konfidencial?

21 Z. MICHALCZUK: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Tani, sa i takon materialit SITF00162664 deri në SITF00162674-
24 ET RED2 pranohet bashkë me serbishten.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo deklaratë besoj që

1 deshët të përfshinit edhe shqipen këtu?

2 Z. MICHALCZUK: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Marrin
4 numrat e provës materiale P01298 dhe klasifikimi është
5 konfidencial.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
7 mbajmë klasifikimin konfidencial.

8 Materiali me numër SITF0019352 deri në SITF00195370-ET
9 Revised RED2, serbishtja dhe shqipja pranohen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo deklaratë merr
11 numrin e provës materiale P011209 [Sipas përkthimit] dhe
12 klasifikimi është konfidencial.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Klasifikimi
14 mbetet i pandryshuar.

15 Tani, materiali SITF00271891 deri në SITF00271891-ET,
16 serbishtja dhe shqipja, pranohen.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës
18 materiale P01300. Klasifikimi është konfidencial.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbetet i
20 pandryshuar klasifikimi.

21 Shënimi përgatitor besoj e kapa mirë numrin, shënimi
22 përgatitor me numrin 121296 deri në 121301 pranohet.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi përgatitor merr
24 numrin e provës materiale P01301 dhe klasifikimi është
25 konfidencial.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm një
2 provë materiale shoqëruese kishit?

3 Z. MICHALCZUK: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 edhe prova materiale shoqëruese pranohet.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Prova materiale merr
7 numrin P0202 [Sipas përkthimit] dhe klasifikimi është
8 konfidencial.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Klasifikimi
10 është konfidencial dhe mbetet i pandryshuar.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do bëj një përmbledhje.

12 Në mes të qershorit të vitit 1999 dëshmitari dhe familja
13 e tij u ndaluan nga anëtarë të armatosur të UÇK-së. Dëshmitari
14 04824 dhe një prej kushërinjve të tij morën, u rrahën dhe u
15 fyen. Më pas i çuan te ndërtesa e konvikteve në Gjilan. Në --
16 atje, te konvikti në Gjilan, Dëshmitari 04824 u morën në
17 pyetje dhe u rrahën. Ata u liruan pas disa orësh, por në të
18 njëjtën ditë. Me kaq përmbyll përmbledhjen, të nderuar
19 Gjykatës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kam disa pyetje shtesë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, kam edhe disa pyetjet. Në deklaratën tuaj keni
25 thënë se gjatë luftës keni punuar në një shkollë. Pyetja ime

1 është na sqaroni cilat ishin detyrat tuaja aty në atë shkollë?

2 PË. Kam qenë si roje, magazinieri i shkollës.

3 PY. A mund të na thoni cila -- si ishte emri i shkollës? Si
4 quhej shkolla?

5 PË. Mund t'ju them. Është shkolla e mësuesve, shkollë
6 pedagogjike.

7 PY. Ku ndodhej kjo shkollë?

8 PË. Rreth 200 metra nga fjetorja e studentëve.

9 PY. Në cilin vend, qytet apo qytezë?

10 PË. Në Gjilan.

11 PY. Si roje shkollës, e keni patur -- kishit -- mbanit armë?

12 PË. Jo.

13 PY. Gjatë seancës përgatitore më herët këtë javë që kemi
14 bërë, na thatë që vëllai juaj -- si ju edhe vëllai juaj, Igori
15 nuk jeni mobilizuar në asnjë moment. A është kështu?

16 PË. E saktë. Flisja për Igorin.

17 PY. E pse nuk është -- nuk i ka ardh thirrja që të
18 mobilizohej?

19 PË. Për arsye mjekësore, nuk mund të ishte në ushtri.

20 PY. Ju kujtohet -- a mund të na thoni në të -- vija të
21 përgjithshme shkaqet apo arsyet mjekësore për të cilat po
22 flisni?

23 PË. Kishte një sëmundje të veshkës dhe vazhdon ta ketë.

24 PY. A e kishte bo ai shërbimin ushtarak të detyrueshëm?

25 PË. Jo.

1 PY. Dëshmitar, keni deklaruar se ju dhe vëllai juaj jeni
2 arrestuar nga pjesëtarët e UÇK-së që edhe ju kanë çuar në
3 konvikte -- në fjetoret në Gjilan. Pyetja është, e
4 kundërshtuat arrestimin ti dhe vëllai?

5 PË. Jo.

6 PY. Gjatë mbajtjes në ndalim nga UÇK-ja e ju informuan
7 ndonjëherë për akuza penale ndaj jush?

8 PË. Jo.

9 PY. Vëllai juaj u informua ai për ndonjë akuzë që ishte
10 ngritur ndaj tij?

11 PË. Jo, as ai jo.

12 PY. A ju dha kush ndonjë sqarim, shpjegim se pse mbajta juaj
13 në ndalim -- e juaja dhe e vëllait ishte e nevojshme, duhej të
14 bëhej?

15 PË. Nuk thanë asgjë, fare.

16 PY. A ju dha juve mundësia që të kundërshtonit mbajtjen tuaj
17 në ndalim përpara ndonjë gjykatësi apo zyrtari?

18 PË. Jo, në asnjë moment.

19 PY. A ju dorëzua juve ndoshta ndonjë vendim për arrestimin
20 tuaj, mbajtjen në ndalim apo lirim?

21 PË. Jo, fare.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kam pyetje të -- nuk kam më
23 pyetje për këtë dëshmitar, të nderuar Gjykatës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 ZNJ. MENEGON [Përkthim] Shoh që Mbrojtësi i Viktimave

1 duket të ketë pyetje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
4 Gjykatës.

5 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

6 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar, a më dëgjoni?

7 PË. Mirëdita, ju dëgjoj.

8 PY. Unë quhem Maria Raziejowska dhe jam Mbrojtësja e
9 Viktimave në këtë çështje. Kam ca pyetje për juve, me qëllim
10 që të kuptojmë më mirë pasojat e ndikimin që mbajtja juaj në
11 ndalim dhe keqtrajtimi juaj nga UÇK-ja në qershor të vitit
12 1999 ka pasur te ju dhe në jetën tuaj. Në rregull?

13 PË. Në rregull.

14 PY. Ju në deklaratën tuaj keni përshtuar se jeni ndaluar dhe
15 rrahur në rrugë, pastaj ju kanë çuar në fjetore, apo konvikt.
16 Aty ju kanë rrahur dhe marrë në pyetje -- pjesëtarë të UÇK-së.

17 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Për nevoja të
18 procesverbalit, kjo gjendet për shembull në PO1297.2 [Sipas
19 përkthimit], rreshtat 20 deri në 21, dhe faqja 13, rreshtat
20 23, 23.

21 PY. Dëshmitar, çfarë mendove se do të ndodhte ty dhe vëllait
22 në atë kohë, në momentin kur ishit të ndaluar dhe
23 keqtrajtoheshit në fjetore, në konvikt?

24 PË. Mendova që do të na vrisnin.

25 PY. A mund të na tregoni cilat ishin lëndimet fizike që

1 pësuar nga këto rrahje?

2 PË. Po.

3 PY. Vazhdoni, na tregoni.

4 PË. Na kishin lidhur duart pas shpine, sytë e mbuluar, dhe

5 pas një fare kohe filluan të na rrihnin me dërrasa dhe

6 zinxhirë. Na goditën në gjithë pjesët e trupit dhe pastaj --

7 PY. Vazhdoni

8 PË. Pastaj një mik i babait tim u ndalua aty, emri i tij --

9 ai quhej Ferik, ishte veshur me uniformë të zezë dhe kur hyri

10 në dhomë ku neve po na keqtrajtonin, ai njohu edhe vëllain tim

11 dhe mua dhe i tha personave që po na rrihnin --

12 PY. Në deklaratën tuaj keni përshkruar në hollësi atë që ju

13 ka ndodhur dhe i kemi të gjitha këto deklaratata, janë tashmë

14 pjesë e provave. Pra nuk keni nevojë të përshkruani në hollësi

15 atë që ju ka ndodhur. Ajo që do të doja të dëgjoja nga ju

16 është plagët, lëndimet që u shkaktuan nga kjo rrahje.

17 PË. M'u thyen tre brinjë dhe më nxinë gjithë trupin. Gjithë

18 trupin e kisha të nxirë. Të paktën gjysma e trupit.

19 PY. Keni -- në deklaratën tuaj keni përshkruar se në një

20 moment të caktuar pas keqtrajtimit në konvikt ju kanë çuar që

21 të laheshit, të pastroheshit, dhe kishit vështirësi të ecnit.

22 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është

23 në provën P01297.2, faqen 14, rreshtat 21, 22.

24 PY. Sa kohë u desh që të shëroheshit dhe të ecnit normalisht

25 vetë?

26

Dëshmitari: Zoran Stankovic (Seancë private)
Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave

Faqe 90

1 PË. Dy muaj. Më janë dashur dy muaj.

2 PY. E sa kohë u desh që të shëroheshit tërësisht, domethënë,
3 në të gjitha pjesët e trupit nga lëndimet që kishit pësuar?

4 PË. Pëso -- kisha edhe traumë psikologjike që zgjati me vite.

5 PY. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë, por të nderuar
6 Gjykatës, do të kërkoja që të kalonim në seancë private për
7 këtë pjesë, për çësh -- për të mbrojtur identitetin e
8 dëshmitarit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

10 Sekretare, na kaloni në seancë private, për mbrojtjen e
11 dëshmitarit.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Gjykatës, tani jemi në
2 seancë publike.

3 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, pak kohë pas mbajtjes tuaj në ndalim në
5 konvikt, jeni larguar nga Kosova, a është kështu?

6 PË. Po.

7 PY. A jeni kthyer ndonjëherë atje që nga ajo kohë?

8 PË. Jo.

9 PY. Sa kohë -- sa gjatë kishin jetuar familja juaj në Kosovë?

10 PË. Tre muaj.

11 PY. E kam fjalën, përpara se të largoheshit nga Kosova,
12 familja juaj sa kohë kishin që jetonin në Kosovë? Që nga cila
13 kohë?

14 PË. Që nga Lufta e Dytë Botërore.

15 PY. Si e përjetuat ju largimi nga Kosova? Te -- jetën tuaj
16 atje?

17 PË. Ishte shumë e vështirë, shumë e vështirë dhe shumë e
18 hidhur.

19 PY. Pse?

20 PË. Në një farë mënyre shpirti mbetet në vendin e lindjes.

21 Vendi ku ke lindur është vendi që -- i vetmi vend që njeh dhe
22 është shumë e vështirë ta lësh mbrapa.

23 PY. Faleminderit, dëshmitar.

24 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk
25 kam më pyetje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
2 znj. Radiovska.

3 Tani radhën e keni ju, znj. Menegon.

4 ZNJ. MENEGON [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

5 Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon:

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

7 PY. Z. dëshmitar, unë quhem Sophie Menegon dhe do t'ju bëj
8 disa pyetje në emër të z. Hashim Thaçi.

9 Kam ca pyetje personale fillimisht. Pra keni lindur në
10 Gjilan, është kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe kishit -- keni jetuar në këtë qytet gjithë jetën
13 tuaj, deri në momentin që jeni larguar në vitin 1999, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Ju keni deklaruar përpara ZPS-së Gjilani nuk ishte qytet
16 i madh dhe pothuaj gjithë njerëzit njiheshin atje. A është
17 kështu?

18 PË. Kështu është.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Në të kaluarën, kur keni -- në
20 shkëmbimet tuaja me ZPS-në, keni përmendur që keni probleme me
21 kujtesën, që keni marrë ilaçe, përmendët edhe sot. A vazhdoni
22 t'i keni këto probleme me kujtesën?

23 Kërkoj ndjesë nëse nuk e dëgjova përgjigjen.

24 PË. Po, po.

25 PY. A mendoni që jeni në gjendje që të kujt -- t'ju kujtohet

1 mirë ajo që ka ndodhur në -- para 25 vitesh, pra në vitin

2 1999?

3 PË. [Nuk ka përkthim]

4 PËRKTHYESI: [Përkthim] Nuk e kuptoj përgjigjen e
5 dëshmitarit. A mund t'i kërkohet atij ta përsërisë, ju lutem?

6 ZNJ. MENEGON [Përkthim]

7 PY. Kërkoj ndjesë, Dëshmitar, a mund ta -- a mund ta
8 përsërisni përgjigjen apo doni që t'ju bëj prapë pyetjen?

9 PË. Përsëri -- përsërisni pyetjen, ju lutem.

10 PY. Pyetja ishte a mendoni që sot ju kujtohen mirë ngjarjet
11 që kanë ndodhur në vitin 1999 në Gjilan?

12 PË. Po, më kujtohen.

13 PY. Atëherë, shkurtimisht do të doja të bisedonim për
14 atmosferën në qytet përpara bombardimeve të natës -- NATO-s.
15 Si do e përshkruanit gjendjen, situatën në qytet në atë kohë,
16 a ishte e qetë?

17 PË. Në pjesën e qytetit ku jetoja unë ishte qetë.

18 PY. Pra, nuk kishte luftime.

19 PË. Jo, nuk kishte.

20 PY. Nuk kishte të burgosur -- nuk kishte prani të UÇK-së në
21 Gjilan në atë kohë përpara bombardimit të NATO-s?

22 PË. Jo, nuk kishte.

23 PY. Dëshmitar, a mund të na tre -- thoni në atë kohë a janë
24 keqtrajtuar disa shqiptarë të Kosovës nga serbët në Gjilan,
25 keni dijeni për këtë?

1 PË. A mund ta përsërisni pyetjen?

2 PY. Nuk isha e qartë. A kishe njohuri ti, a dije që kishte
3 tensione në atë kohë mes serbëve dhe shqiptarëve në Gjilan dhe
4 kjo ka çuar që serbët -- forcat serbe të -- për shembull të
5 sulmojnë disa shqiptarë të Kosovës?

6 PË. Po.

7 PY. Do të doja -- tani do t'ju bëj pyetje lidhur me dy
8 ngjarje. A e dini që në prill forcat serbe thuhet të kenë
9 plaçkitur dhe abuzuar fizikisht shqiptarët në këtë qytet sipas
10 raporteve të refugjatëve, dhe disa refugjatë o ashtu
11 pretendojnë se më 16 prill njësitë paraushtarake kanë
12 urdhëruar të gjithë shqiptarët që të largohen nga qyteti ose
13 do të vriteshin. Thu -- sipas raporteve, të paktën një mijë
14 vetë janë larguar, dhe janë arrestuar nga forcat serbe gjatë
15 rrugës.

16 ZNJ. MENEGON [Përkthim] Këtë që po citoj, për nevoja të
17 procesverbalit, është referenca DHT09 -- 03986 [Sipas
18 përkthimit]

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ku është -- kundërshtojmë këtë
20 për -- në bazë të mungesës së relevancës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ku është
22 relevanca e kësaj? Kjo bëhet fjalë -- këtu jemi për përvojën e
23 këtij -- atë që ka përjetuar vetë ky person. E vetmja gjë që -
24 - për të cilën ai ka dëshmuar është kjo.

25 ZNJ. MENEGON [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

1 Gjykatës. Në fakt desha të -- se -- të bëja këtë pyetje sepse
2 në dosjen paraprake të ZPS-së bisedohej për, trajtoheshin
3 ngjarjet në Gjilan vetëm nga qershori i vitit 1999, dhe
4 mendova që ishte relevante të kuptonim edhe kontekstin e
5 qytetit përpara këtyre ngjarjeve në konviktin. Është -- bëhet
6 gjithashtu fjalë për besueshmërinë e dëshmitarit, nëse ai
7 kishte dijeni për incidente të tilla. Por do të kaloj këtë
8 pjesë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kam
10 dëgjuar asnjë pyetje lidhur me besueshmërinë e tij deri tani.
11 Mund ta bëni pyetjen.

12 ZNJ. MENEGON [Përkthim] Të vazhdojmë më tej.

13 PY. Dëshmitar, do të doja që të shqyrtojmë pak marrëdhënien
14 tuaj familjare me policinë serbe dhe ushtrinë serbe. Kuptoj që
15 keni -- di që keni dy vëllezër, Igori dhe Dejan Stankovic.
16 Është kështu?

17 PË. Po.

18 PY. A keni ndonjë vëlla tjetër?

19 PË. Kam një kushëri, Dragani, që është djali i xhaxhait tim.

20 PY. Dhe vëllai -- babai i Draganit ka emrin Milorad
21 Stankovic, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dëshmitar, gjatë intervistës suaj dhënë ZPS-së keni
24 deklaruar se në atë kohë në Kosovë -- se natyrisht në atë kohë
25 ju kishit armë gjatë luftës.

1 ZNJ. MENEGON [Përkthim] Po i referohem këtu intervistës
2 suaj në -- dhënë ZPS-së në faqen 16.

3 PY. Pyetja është sa armë kishit në atë kohë?

4 PË. Nuk e kuptova pyetjen. Po ndërpritet zëri.

5 PY. E përsëris. ZP -- keni deklaruar para ZPS-së se që gjatë
6 luftës keni mbajtur armë. Pyetja ime është sa armë keni pasur
7 dhe çfarë lloj armësh keni pasur në shtëpi?

8 PË. Nuk më kujtohet. Kishim një pushkë që ishte e vëllait
9 tim, Dejanit, dhe një uniformë. Kishim gjithashtu edhe armë
10 gjahu.

11 PY. Faleminderit. Autoritet -- a kanë armatosur autoritete
12 serbe dhe civilët në momentin e shpërthimit të konfliktit në
13 vitin 1998?

14 PË. Nuk e di. Ndoshta kanë armatosur disa dhe jo të tjerë.

15 PY. A mund të konfirmoni që mobilizimi i përgjithshëm është
16 bërë më vonë pastaj, në mars të vitit 1999, kur ka filluar
17 fushata e bombardimeve të NATO-s?

18 PË. Po.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. MENEGON [Përkthim] Besoj që është ora e pushimit të
21 drekës, ose ju dëshironi, mund të vazhdoj.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
23 shumë.

24 Dëshmitar, do bëjmë pushimin e drekës. Keni një orë e
25 gjysmë për drekë, dhe vazhdojmë pastaj në orën 14.30.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Zoran Stankovic (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon

Faqe 98

1 Znj. Sekretare, mund të shoqëroni dëshmitarin.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërpritet
5 seanca deri në orën 14.30.

6 --- Pushimi i drekës fillon në orën 13.02

7 --- Seanca rifillon 14.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

9 Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin. Znj. Sekretare, silleni
10 dëshmitarin.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

12 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
13 këshillohen]

14 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes
15 videolidhjes]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, na
17 dëgjoni mirë?

18 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
20 vazhdojmë tani me dëshminë tuaj.

21 Znj. Menegon, jeni ju. E keni radhën ju.

22 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Z. Dëshmitar, do të vijojmë me pyetjet. Do t'ju bëj nja
24 dy pyetje lidhur me përfshirjen e familjes suaj në forcat
25 serbe.

1 Ju thatë që vëllai Igor nuk është mobilizuar ndonjëherë
2 për shkak të problemeve shëndetësore. Mendoni se njerëzit që e
3 arrestuan nuk do ta kenë ditur që ka pasur probleme dhe nuk
4 ishte mobilizuar?

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kjo është një spekulim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, ju thatë se jeni mobilizuar si roje në
9 shkollën pedagogjike të Gjilanit. Sa zgjati kjo punë?

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është keqpërshkrim. Nuk ishte
11 roje, ishte pastrues. Është një funksion tjetër.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Të presim përgjigjen.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni
14 pyetjen dhe përdorni termin e duhur. Ishte pastrues dhe jo
15 roje.

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

17 PY. Për sa kohë punuat në shkollës si pastrues?

18 PË. Tre muaj.

19 PY. Dëshmitar, faleminderit. E dini se vëllai juaj Igor,
20 është intervistuar nga një gjykatës hetues i Gjykatës së Lartë
21 të Beogradit dhe ka thënë se në atë kohë ai dhe ju kishit një
22 uniformë në një moment.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dhe e kam fjalën për provën
24 materiale SITF00195371-SITF00195397-ET, faqe 8.

25 PY. E dëgjuat pyetjen apo ta përsëris?

1 PË. Po.

2 PY. E dinit ju që vëllai juaj është intervistuar në Beograd
3 dhe ka thënë që në një moment ju dhe ai kishit, zotëronit një
4 uniformë. A e keni ditur këtë?

5 PË. Po.

6 PY. Faleminderit. Gjatë seancës përgatitore dhe e kam fjalën
7 për dokumentin P1301 paragrafi 9, ju pohuat se vëllai juaj
8 Dejani është marrë si rezervist gjatë luftës. Ka qenë kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Nga informacioni që kemi, dhe e kam fjalën për dokumentin
11 077583-TR-ET Pjesa 1, faqja 8 dhe 10 - kushëriri juaj Dragan
12 Stankovic e ka kryer shërbimin ushtarak dhe në 1981 -- dhe ka
13 punuar gjatë konfliktit të 1998 dhe 1999 si rezervist polic,
14 si polic rezervist. Pajtohet me atë që ju dini?

15 PË. Nuk ka punuar, ishte thjesht rezervist ushtarak.

16 PY. E dini se ku e ka kryer këtë shërbim si rezervist?

17 PË. Ishte aty në qytet.

18 PY. Por armë kishte si rezervist?

19 PË. Po.

20 PY. Babai i Draganit, Milorad Stankovic, edhe ai është
21 mobilizuar dhe është angazhuar në ushtri. Është e saktë kjo?
22 Gjatë luftës.

23 PË. Ishte thjesht shofer dhe i veshur, mbante tesha civile.

24 PY. Pra, sipas informatave që keni ju, nuk ka qenë rezervist,
25 nuk ka qenë i mobilizuar?

1 PË. Jo.

2 PY. Dëshmitar, sipas informacioneve që kemi ne, Dragani ka
3 thënë që i ati, Miloradi ka qenë i mobilizuar dhe e kam fjalën
4 për dokumentin 007583-TR-ET, Pjesa 1, faqja 10. E pranoni ju
5 këtë që ai ka qenë i mobilizuar apo jo?

6 PË. Po, ka qenë i mobilizuar por ishte, mbante tesha civile
7 sepse ishte thjesht shofer.

8 PY. Faleminderit. Pra, të gjithë pothuajse të gjithë anëtarët
9 e familjes tuaj kanë qenë të mobilizuar gjatë konfliktit në
10 një kohë të caktuar. Ka qenë kështu?

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sapo përmendi tre individë dhe
12 kolegia thotë "shumica e burrave". Mund të kenë qenë 20 burra
13 në familje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të jeni më e
15 saktë.

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

17 PY. Pra, kushëriri juaj, ju dhe Miloradi jeni mobilizuar
18 gjatë luftës si rezervistë. Këtë e konfirmuat, apo jo?

19 PË. Vëllai im po, por -- vëllezërit e mi po, por unë, jo.

20 PY. Po juve jeni mobilizuar si pastrues, edhe kjo ka qenë
21 pjesë e mobilizimit. Unë të paktën kështu e kuptova nga
22 dëshmia juaj.

23 PË. Jo. Për tre muaj kisha kontratë me shkollën për tre muaj
24 të punoja si pastrues sepse personi -- personat që më parë
25 kryenin këto detyra ishin mobilizuar.

1 PY. Faleminderit. Pra, Gjilani është një vend i vogël dhe
2 besoj të gjithë e dini se çfarë pune bënte secili, apo jo? Pra
3 fqinjët për shembull e kanë ditur që ju keni qenë të
4 mobilizuar?

5 PË. Po. Po, e dinin.

6 PY. Tani të kalojmë tek fakti që shtëpia juaj është djegur.
7 Ju thatë që shtëpinë ua dogjën, kështu? Por thatë që nuk ishit
8 i pranishëm kur ndodhi kjo.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lëreni të
10 përgjigjet pastaj vazhdoni.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

12 PY. Ju e konfirmuat që është djegur. A mund ta konfirmoni
13 përsëri që nuk keni qenë i pranishëm kur ndodhi kjo?

14 PË. Është e saktë, ashtu është.

15 PY. Pra, nuk e patë me sytë tuaj nëse djegur aksidentalisht
16 apo është bërë qëllimisht nga dikush?

17 PËRKTHYESJA: Përkthyesit thonë që nuk e kanë dëgjuar
18 përgjigjen.

19 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

20 PY. Mund ta përsërisni edhe një herë, ju lutem se nuk e kanë
21 dëgjuar përkthyesit?

22 PË. Ja vunë zjarrin qëllimisht, e dogjën qëllimisht.

23 PY. Po ju s'keni qenë vetë i pranishëm. Pse e thoni këtë?

24 PË. Kështu mendova sepse mbase e bënë për faktin që
25 vëllezërit ishin mobilizuar në ushtri. Do ta ketë bërë ndonjë

1 fanatik për të treguar që nuk ishte e drejtë kjo gjë.

2 PY. E kuptoj pra, mund të thoni se e kanë bërë për hakmarrje.

3 Tani dua që të diskutojmë për atë që ka ndodhur një ditë
4 përpara ndalimit tuaj të pretenduar. Ju thatë që disa njerëz
5 erdhën në shtëpinë tuaj dhe morën disa pajisje ushtarake.

6 Kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe ju thatë që dy nga ata që erdhën ishin z. Gaçika
9 [Sipas përkthimit] dhe Osmani. Nga e dini ju? Ishin në lagjen
10 tuaj ata?

11 PË. Jo, nuk ishin nga lagjja jonë.

12 PY. E dini nga ishin?

13 PË. Jo, nuk e di.

14 PY. Nga e more vesh këtë?

15 PË. Unë nuk i njihja. Ata ishin fqinjët e mi, por ne s'kishim
16 punë me ta. Ata thjesht banonin ngjitur me shtëpinë time.

17 PY. Pra, banonin ngjitur me ju? Faleminderit.

18 PË. Po, po.

19 PY. Tani dua që të diskutojmë lidhur me marrjen në pyetje te
20 konvikti.

21 Ju i thatë ZPS-së se ata ju pyetën nëse kishit armë dhe
22 ju pyetën për kushëririn Dragan.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] E kam fjalën për dokumentin P01
24 [Sipas përkthimit] në faqen 12, P01297.2 në faqen 12.

25 PY. Kështu ka qenë?

1 PË. Po.

2 PY. Vëllai juaj Igor u mor në pyetje në 2011, dhe ishte
3 pyetur nëse kishte vrarë dikë.

4 PË. Po.

5 PY. Ai tha se juve ju pyetën nëse kishit vrarë dikë?

6 PË. Po.

7 PY. Disa prej njerëzve që u morën me arrestimin tuaj, Ademi
8 dhe Muharremi ishin nga Gjilani, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, ka të ngjarë që këta njerëz e kanë ditur që ju apo
11 Dragani apo babai ishit mobilizuar?

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëshmitar, nuk tha asnjëherë që
13 është mobilizuar vetë.

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po e riformuloj.

15 PY. Pra, është e saktë që këta njerëz duhet ta kenë ditur që
16 Dragani dhe babai janë mobilizuar, kështu?

17 PË. Po, sepse ishim në -- ishim në marrëdhënie të mira,
18 shoqëroheshim me njëri-tjetrin.

19 PY. Është e mundur që ata ju arrestuan juve dhe kushëririn
20 sepse mendonin se ishit ushtarë aktivë në ushtrinë serbe.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kjo është spekulim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

23 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po

24 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

25 PY. Tani do të kalojmë te tema e lirit tuaj. Ju thoni që

1 një mik i babait, Feriku, të cilin e përshkruani si një lloj
2 komandanti hyni në dhomën ku ju mbanin ju të ndaluar dhe
3 ndihmoi që t'ju lironin, kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Pastaj ju i thatë ZPS-së se Feriku ju tha që të shkonit
6 në banjë për t'u freskuar?

7 PË. Po, ashtu ishte.

8 PY. I thatë Prokurorisë se Feriku ju mori -- ju çoi në një
9 zyrë të konviktit ku ishte një person i veshur me tesha me
10 uniformë kamuflazh që ju e përshkruani si komandant?

11 PË. Po.

12 PY. Ju thoni që ai bisedoi me Ferikun dhe pas pak ju liruan,
13 e saktë?

14 PË. Po.

15 PY. Duket se ky personi që ju e përshkruani si komandant e
16 rrahura pushoi dhe juve ju liruan pas pak.

17 PË. Po.

18 PY. Mendoni se e rrahura nuk është bërë me miratimin e dikujt
19 por thjesht nga banorët që mund t'ju merrnin -- donin të
20 merrnin hak?

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Spekulum.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

24 PY. Pra, ju thoni nuk është shumë e qartë nëse jeni liruar në
25 të njëjtën kohë me vëllain Igor. Në 2002 në deklaratën e parë

1 keni thënë që ju lanë të largoheshit që të sillnit një armë.

2 Por, e mbajtën vëllain aty. Ju kujtohet kjo?

3 PË. [Nuk ka përkthim]

4 PY. Dhe kemi një raport nga policia serbe, nuk e kemi
5 përgjigjen në transkript.

6 PË. Po ashtu ka qenë. Nuk dëgjova mirë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i bëjmë mbase pyetjet më
8 të thjeshta që t'i kuptojë dëshmitari.

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po.

10 PY. Dëshmitar, në deklaratën e 2002 keni thënë që ju liruan
11 një herë personi që u mbajti aty për të sjellë një armë. Ka
12 qenë kështu?

13 PË. Nuk e mbaj mend tani.

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mbase mund t'ju tregoj
15 dokumentin. Është dokumenti P01300. Në anglisht dhe në
16 serbisht.

17 PY. Në mes të deklaratës së 2002 thotë që:

18 "Më lejuan të largohesha të ikja që t'ju sillja një armë,
19 por e mbajtën vëllain tim aty, Igorin."

20 E sheh?

21 PË. Po, po. Po.

22 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mund ta largoni nga ekрани.

23 PY. Kemi një raport nga policia serbe bazuar në deklaratën e
24 2002.

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dhe e kam fjalën për dokumentin

1 SITF002718890-SITF00271891-ET, faqja 1.

2 Sipas këtij raporti ata thonë të njëjtën gjë që ju lanë
3 të lirë që të sillnit një armë dhe vëllain e mbajten derisa të
4 ktheheshit ju.

5 Gjatë intervistës Prokuroria ju pyeti se çfarë ndodhi dhe
6 fillimisht ju thatë, po. Pastaj shtuat një shpjegim tjetër ku
7 thoni se ju kanë liruar bashkë me vëllain.

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dhe i referohem dokumentit
9 P1297.2, faqja 4, 5.

10 Ju kujtohet kjo?

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Prapë është pyetje shumë e
12 komplikuar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni
14 pyetjen më të thjesht që ta kuptojë dëshmitari.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, Prokuroria ju ka pyetur nëse atë që keni thënë
17 gjatë intervistës së parë që ju liruan por që e kanë mbajtur
18 Igorin që të sillnit armët, kështu ka qenë?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Tha po.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

21 PY. Pra, pyetja ime është kjo, pyetja që kam është kjo: Ju e
22 ndryshuat deklaratën, thatë që u liruat të dy me vëllain. Ju
23 kujtohet kjo? Pse nuk thatë që në fillim që ju u liruat bashkë
24 me vëllain.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Janë dy pyetje në një dhe

1 dëshmitari nuk e di se kujt i përgjigjet.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është edhe
3 pak pyetje -- nuk është tamam pyetje është më shumë pyetje e
4 diskutueshme, është më shumë si argument.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

6 PY. Ju i thatë Prokurorisë që u liruat bashkë me Igorin,
7 kështu? Në të njëjtën kohë?

8 PË. Po. Po.

9 PY. Faleminderit. Ju i thatë Prokurorisë gjithashtu se kur ju
10 lejuan të largoheshit për të marrë armën, ju nuk sollët sepse
11 nuk kishit armë, kështu?

12 PË. Ashtu.

13 PY. Dhe kjo është për faktin që ata që erdhën në shtëpinë
14 tuaj një ditë më përpara e morën atë armën që kishit?

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kundërshtoj. Ishte një municion
16 dhe një uniformë dhe jo armë.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] E kam fjalën te intervista që i
18 ka dhënë Prokurorisë dëshmitari, me numër P1297.2, faqja 16.
19 Mbase mund ta sqarojë dëshmitari.

20 PY. Dëshmitar, a e morën armët që kishit në shtëpi ata që
21 erdhën?

22 PË. Po.

23 PY. E dini që kur u intervistua në 2011 Igori, vëllai juaj ka
24 thënë që pasi u arrestuan kishit akoma një armë automatike që
25 ishte në karrocërinë e traktorit.

- 1 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dhe e kam fjalën për dokumentin
2 SITF00195371-SITF00195397-ET në faqen 9.
3 PY. A e dini këtë se vëllai tha se ju vazhdonit të kishit një
4 armë të fshehur në karrocerinë e traktorit?
5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nga ta dinte ai?
6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Duhet ta formuloj ndryshe
7 pyetjen.
8 PY. Dëshmitar, a kishit një armë në karrocerinë e traktorit
9 kur u arrestuat?
10 PË. Jo.
11 PY. Faleminderit. Kam edhe dy tema të fundit. Dua të diskutoj
12 atë që keni thënë vazhdimisht se nuk e keni ditur kush
13 përgjigjej për ata se pretendoni se ju kanë arrestuar. Kështu
14 është?
15 PË. Po. Po.
16 PY. Do të ishte e drejtë të thoshim se nuk keni idenë nëse ka
17 pasur ndonjë zinxhir komandues apo nëse ka pasur ndonjë
18 komandant aty, kështu?
19 PË. Po.
20 PY. Tema e fundit është konvikti. Ju e dinit e njihnit
21 konviktin, e dinit si ishte nga brenda e nga jashtë, apo jo?
22 PË. Po.
23 PY. Sepse mesa kam parë, ju banonit përballë konviktit?
24 PË. Në anën tjetër, pranë kolegjit të lartë pedagogjik, rreth
25 200 metra më larg.

1 PY. Pra, e njihnit ndërtesën?

2 PË. Po, aty jam rritur.

3 PY. Gjatë intervistave me ZPS-në ato iu treguan dy fotografi.

4 Ju kujtohet -- të kësaj ndërtesës?

5 PË. Po, e mbaj mend.

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mbase është më mirë ta paraqesim
7 në ekran këtë dokument.

8 PY. Dëshmitar, kur ja u tregoi Prokuroria këtë dokument, ju
9 thatë që tregon spitalin në Gjilan, ndërsa gjatë seancës
10 përgatitore shtuat që tregon dhe shkollën.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Të kalojmë në faqen e dytë.

12 PY. Të dyja këto fotografi tregojnë konviktin. Jeni dakord me
13 mua?

14 PË. Jo, nuk është -- nuk duket si konvikti.

15 PY. A mund të na e përshkruani sesi ishte vendi ku ju kanë
16 mbajtur të ndaluar?

17 PË. Ishte një ndërtesë me ngjyrë të kuqe, kjo këtu nuk më
18 duket fare si ajo. Më duket më shumë si shkolla Sadrik
19 Hallaqi.

20 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera.

21 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z.

23 Roberts. Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje as ne.

24 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kemi as ne pyetje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë

1 pyetje Prokuroria?

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

3 Pyetje nga Trupi Gjykses:

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shpresoj të më dëgjoni mirë.

5 PË. Po, ju dëgjoj, i nderuar.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në qoftë se nuk gabohe, ju

7 folët për kushëririn tuaj, Milorad Stankovic, babai i

8 kushëririt, që është në fakt xhaxhai juaj. Kështu?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në përgjigje të pyetjes që

11 ju bëri Mbrojtja e z. Thaçi ju thatë që ai ngiste makinën dhe

12 nuk ishte i veshur me uniformë.

13 PË. Po, ishte një kamion civil.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë transportonte ai?

15 PË. Armë, ushtarë. Më duket se transportonte armë për

16 ushtrinë. Besoj që kështu ka qenë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk kam

18 pyetje të tjera.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka pyetje

20 të tjera nga Trupi Gjykses.

21 Ndonjë pyetje? Nuk ka më pyetje.

22 Z. Roberts?

23 Dëshmitar, këtu përfundon dëshmia juaj. Ju falënderojmë

24 që erdhe, ju urojmë gjithë të mirat. Punonjësja e Gjykatës do

25 t'ju shoqërojë të dilni nga salla.

1 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes
4 videolidhjes]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Shumë shpejt do të nxjerrim një urdhër për dëshmitarët që
7 diskutuam më herët gjatë seancës së sotme. Do të bëjmë të
8 pamundurën që të respektojmë kalendarin që do të nxjerrim. Do
9 të gjejmë një zgjidhje. Faleminderit për bashkëpunimin.
10 Faleminderit për sugjerimit që na dhatë.

11 Kemi një shkëputje dyjavore. Do të rishihemi pas dy
12 javësh.

13 --- Seanca përfundon në orën 15.01

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25